

VENDIM
Nr. 77, datë 24.7.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “WTS ENERGJI” SHPK ME NR. 16, SERIA PV04P,
LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 39, DATË 22.7.2004**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b” pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 22.7.2013 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “WTS Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. me nr. 16, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike, nga HEC “Tamare” me fuqi 180 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 22.7.2004.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani